



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 134, datë 27.07.2023



PËR MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË PRONËS ME NUMËR LISTE TË TRANSFERIMIT 258, ME EMËRTIM “VENDSTREHIM”, ME VENDODHJE PRANË SHKOLLËS SË MESME “GJERGJ KASTRIOTI” , QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.280, datë 15.01.1996, “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, shkresës nr. 90/1, datë 22.02.2023, me lëndë: “Kthim përgjigje shkresës nr. 1804 prot., datë 15.02.2023”, ardhur nga Ndërmarrja Rruga, shkresës nr. 180/2, datë 02.3.2023, me lëndë: “Informacion për objektin fortifikues në Shkollën e Mesme “Gjergj Kastrioti”, Durrës, shkresës nr. 2702/2 prot., datë 15.5.2023, me lëndë: “Miratim për prishje objekti “vendstrehim”, në pasurinë 25/186, vol.38, fq.186, ZK 8512, në Bashkinë Durrës”, ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, Vendimit nr. 720/1, datë 29.5.2023, me emërtimin “Rindërtim i shkollës së Mesme “Gjergj Kastrioti”, sipas kërkesës të Drejtorisë së Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare si dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për heqjen nga lista e pronave të pronës me nr. 258, me emërtim “vendstrehim”, me vendodhje pranë Shkollës së Meme “Gjergj Kastrioti”, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi Bashkisë Durrës, për shkak se është e dëmtuar dhe është jashtë funksionit, kjo edhe sipas konkluzionit të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Drejtoria Ekonomike dhe Ndërmarrja Rruga, bazuar në Ligjin nr.10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, për reflektimin në regjistrat e Aktiveve të Ndërmarrjes, të pronës me nr. 258, me emërtim “vendstrehim”, me vendodhje pranë Shkollës së Meme “Gjergj Kastrioti”.
3. Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, bazuar në Ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.111/2018, “Për kadastrën”, dhe VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, të përditësojë pronën me nr. 258, duke kryer shënimet që bëjnë fjalë për heqjen e këtij objekti nga regjistrat e pronave të transferuara në pronësi Bashkisë Durrës, si dhe në regjistrat publik pranë ASHK-së Durrës.
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e objektit fortifikues, sipas lejes së ndërtimit, e miratuar me Vendim nr. 720/1, datë 29.5.2023, të përdoret për rindërtimin e godinës së Shkollës së Meme “Gjergj Kastrioti”, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e 26 Nëntorit 2019.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ekonomike, Ndërmarrja Rruga dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi





U shpall sot me datë 28.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 525/ prot.
11

Durrës, më 31 . 07 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 134 datë 27.07.2023 “Për miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me numër liste të transferimit 258, me emërtim “vendstrehim”, me vendodhje pranë shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti”, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

